



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 513/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Adnan Konushevci dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e koalicionit NISMA-AKR-PD, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 24.11.2019, mori këtë:

V E N D I M

PRANOHET e bazuar ankesa Anr.513/2019 e datës 24.11.2019, e paraqitur nga koalicioni NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, **URDHËROHET** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) - Qendra e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), që 1 (një) fletëvotim në Vendvotimin 2608D/01R, të vlerësohet i pavlefshëm, dhe i njëjti të largohet nga votat e vlefshme dhe nga rezultati përfundimtar i publikuar me datë 07.11.2019.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 24.11.2019, ka pranuar ankesën Anr.513/2019 nga koalicioni NISMA-AKR-PD, në të cilën pretendohet se me datë 23.11.2019 në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR), gjatë procesit të rinumërimit, në Vendvotimin me numër 2608D/01R është shpallur i vlefshëm 1 (një) fletëvotim, dhe sipas parashtruesit të ankesës, ky fletëvotim duhet të shpallet i pavlefshëm bazuar në Doracakun e Procedurave të Votimit dhe Numërimit për arsye se nuk kemi të bëjmë me votim dhe qartësi të qëllimit të votuesit, por kemi të bëjmë me një shkrim fyerje siç edhe mund të lexohet në hapësirën përkrah subjektit politik me nr.133. Si provë për pretendimet e tyre ankesës i kanë bashkangjitur shtojcën nr.8 (Mostër e fletëvotimit të pavlefshëm) dhe kopjen e fletëvotimit të ankimuar.

Në përgjigjen e KQZ-së, të pranuar përmes email-it, më datë 24.11.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), thekson se në rastin e vendvotimit 2608D/01R fletëvotimi është shpallur i vlefshëm për arsye se tek subjekti 133 votuesi ka tekst e cila nuk e bënë të pavlefshëm qëllimin e votuesit.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesës, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura në ankesë dhe hetimit në QNR në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Koalicioni NISMA – AKR – PD, si palë ankuese, në kuptim të nenit 105 paragrafi 1 të LZP-së, brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë në PZAP, ku ka kërkuar që ky fletëvotim të shpallet i

pavlefshëm pasi që nuk kemi të bëjmë me votim, por kemi të bëjmë me një shkrim fyerje siç edhe mund të lexohet në hapësirën përkrah subjektit politik me nr.133.

Paneli, me rastin e pranimit të ankesës dhe përgjigjes në ankesë ka formuar ekipin hetues dhe ka dërguar në QNR, për të zhvilluar hetime në raport me pretendimet e cekura nga ankuesi. Pas përfundimit të hetimit në QNR, ekipi hetues ka gjetur se qëndron pretendimi i ankuesit se fletëvotimi i gjetur në kutinë e votimit 2608D/01R duhet të shpallet i pavlefshëm pasi që është konstatuar se në hapësirën përkrah subjektit politik GIG me nr.133 është evidentuar një shkrim fyerje.

Në fletëvotimin që është ekzaminuar shihet se qëllimi i votuesit nuk ka qenë i qartë, kështu që Paneli ka shpallur të pavlefshëm këtë fletëvotim, pasi që nga ekzaminimi i të njëjtit ka rezultuar se nuk i përmbush kriteret e vlefshmërisë, dhe i njëjti duhet të largohet nga votat e vlefshme dhe nga rezultati përfundimtar i publikuar me datë 07.11.2019.

PZAP-i, më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura vendimin e ka bazuar në nenin 119 paragrafi 5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Rezultati që del nga pavlefshmëria e fletëvotimit si në dispozitiv të këtij vendimi, e të cilin fletëvotim e gjeni të bashkangjitur me këtë vendim, duhet të largohet nga votat e vlefshme dhe nga rezultati përfundimtar i publikuar me datë 07.11.2019.

Andaj, Paneli në kuptim të nenit 117, 118 dhe nenit 120 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 513/2019 më datën 24.11.2019**



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.



1. **Shprehja e votës**
Çështja: SAPO JEDAN politik subjekt

2. **Shprehja e votës**
Çështja: SAPO JEDAN politik subjekt

<input type="checkbox"/> 111. PARTIA LIBERALE EGJIPTIANE - PLE	1	2	3	4
<input type="checkbox"/> 112. PPA PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - PDK	5	6	7	8
<input type="checkbox"/> 113. PPV PARTIA E ASHKALINJËVE PER INTEGRIM - PAI	9	10	11	12
<input type="checkbox"/> 114. STRANKA DEMOKRATISKE AKCIE - SDA	13	14	15	16
<input type="checkbox"/> 115. PPS PARTIA KOSOVSKIKI SRBA - PKS	17	18	19	20
<input type="checkbox"/> 116. PPA PARTIA DEMOKRATIKE E ASHKANLIVE TE KOSOVËS - PDAK	21	22	23	24
<input type="checkbox"/> 117. POKRET ZA GORA - PG	25	26	27	28
<input type="checkbox"/> 118. NOVA DEMOKRATISKA STRANKA - NDS	29	30	31	32
<input type="checkbox"/> 119. AAK-PPS PSD - KOALICIONI 100% KOSOVË	33	34	35	36
<input type="checkbox"/> 120. SLOBODA	37	38	39	40
<input type="checkbox"/> 121. SAMOSTALNA LIBERALNA STRANKA - SLŠ	41	42	43	44
<input type="checkbox"/> 122. NISMA SOCIALDEMOKRATË - ALEANGA KOSOVA E RE (PP) PARTIA E DRËJTËSISË	45	46	47	48
<input type="checkbox"/> 123. JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA - JGP	49	50	51	52
<input type="checkbox"/> 124. V KOALICIA VAKAT	53	54	55	56
<input type="checkbox"/> 125. FJALJA	57	58	59	60
<input type="checkbox"/> 126. LEVIZJA VETEVEDOSJEI	61	62	63	64
<input type="checkbox"/> 127. KOSOVA DEMOKRATIK TURK PARTISI - KOTP	65	66	67	68
<input type="checkbox"/> 128. PARTIA ROMË E BASHKUAR E KOSOVËS - PREBK	69	70	71	72
<input type="checkbox"/> 129. PARTIA EURDITLANTIKE E KOSOVËS - PEK	73	74	75	76
<input type="checkbox"/> 130. KOSOVAKI NEVI ROMANI PARTIA - KNRP	77	78	79	80
<input type="checkbox"/> 131. INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS - IRDK	81	82	83	84
<input type="checkbox"/> 132. EBMIR KASI	85	86	87	88
<input type="checkbox"/> 133. GRADANSKA INICIJATIVA GORE - GIG	89	90	91	92
<input type="checkbox"/> 134. LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - LDK	93	94	95	96
<input type="checkbox"/> 135. SRPSKA LISTA	97	98	99	100
	101	102	103	104
	105	106	107	108
	109	110		

123.  JEDINSTVENA GORANSKA PARTIJA - JGP

124.  KOALICIJA VAKAT

125.  FJALA

126.  LËVIZJA VETËVENDOSJEI

127.  KOSOVA DEMOKRATIK TÜRK PARTISI - KDTP

128.  PARTIA ROME E BASHKUAR E KOSOVËS - PREBK

129.  PARTIA EUROATLANTIKE E KOSOVËS - PEK


130.  KOSOVAKI NEVI ROMANI PARTIA - KNRP

131.  INICIATIVA E RE DEMOKRATIKE E KOSOVËS - IRDK

132. ESMIR KASI

133.  GRADANSKA INICIJATIVA GORE - GIG

134.  LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS - LDK

135.  SRPSKA LISTA

miri to gjithë e përdor

53	54	55	56
57	58	59	60
61	62	63	64
65	66	67	68
69	70	71	72
73	74	75	76
77	78	79	80
81	82	83	84
85	86	87	88
89	90	91	92
93	94	95	96
97	98	99	100
101	102	103	104
105	106	107	108
109	110		